

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-79/12

Prishtinë, 5 dhjetor 2012

Në çështjen juridike të:

H. B.

Pala ankuese

Kundër

R. J.

Paraqitësja e kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Antarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/121/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA00081), të datës 7 shtator 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 5 dhjetor 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa e H. B. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/121/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00081), e datës 7 shtator 2011.

- 2- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 103 € (njëqind e tri euro), brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 30 maj 2006, R. J. ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar riposëdimin e pronës që ndodhet në Gjilan, ngastrat Nr. 892, 893 dhe 894 (me sipërfaqe të përgjithshme prej 1 ha 61 ari e 65 m²). Ajo ka pohuar se është pronare e pronave të cilat i zotëronte por i është dashur të largohej për shkak të konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999. Për të mbështetur kërkesën e saj, ajo ndërmjet tjerash ka paraqitur në AKP dokumentet e mëposhtme:

- Fletën poseduese Nr. 786 të datës 08 gusht 2005, të lëshuar nga UNMIK-u në emër të paraqitëses së kërkesës R. J. lidhur me tri ngastra – 892, 893 dhe 894;
- Kontratën e shitblerjes për një arë në zonën e fshatit Livoç i Epërm, në vendin e quajtur “Jaruge”, e datës 14 dhjetor 1950 në të cilën B. J. ishte blerës. Sipërfaqja e tokës nuk specifikohet, ajo individualizohet me një përshkrim të detajuar të kufijve të arës;
- Kontratën e shitblerjes për një arë në zonën e fshatit Livoç i Epërm, në vendin e quajtur “Jaruge”, e datës 25 dhjetor 1965 në të cilën B. J. ishte blerës. Sipërfaqja e tokës nuk specifikohet, ajo individualizohet duke iu referuar Fletës Poseduese me numër 1853;

AKP-ja i ka njoftuar palët potenciale të interesuara për ekzistimin e kërkesës duke vendosur lajmërimë në arë (në të tri ngastrat) për dy herë radhazi – më 28 tetor 2008, me 10 dhjetor 2009. Ka pasur edhe një njoftim shtesë, nga 1 qershori 2011 kur lajmërimi ishte vendosur edhe para objektit, që ndodhet në ngastrën 893. Në përgjigje të njoftimit të dytë, R. B., i lindur me 03 gusht 1958, ka njoftuar Sekretarinë Ekzekutive se ai kërkon të drejtat lidhur me ngastra e kontestuara (ai ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes më 10 dhjetor 2009). Pala përgjegjëse në kërkesë ka pohuar se ai është pronari i ligjshëm dhe ka paraqitur dokumente të ndryshme, ndër

të tjera edhe kontratën për transferimin e pronave të nënshkruara nga Stanojević Tutina Arsenija si shitës dhe R. A. si blerës, e datës 18 shkurt 1941. Ai nuk ka paraqitur ndonjë provë se ka ndonjë afërsi me blerësin.

Me vendimin KPCC/D/A/121/2011, e datës 07 shtator 2011, KKPK-ja ka pranuar se kërkesa është e bazuar. Komisioni ka vlerësuar se dokumentet e paraqitura legjitimojnë paraqitësin e kërkesës si pronarë të ligjshëm. Përndryshe, pala përgjegjëse në kërkesë nuk ka vërtetuar ndonjë lidhje familjare me personin që pretendonte se i kishte trashëguar të drejtat e tij – R. A..

Vendimi iu është dorëzuar palëve – më 22 dhjetor 2011 paraqitëses së kërkesës R. J. dhe me 08 dhjetor 2011 palës përgjegjëse në kërkesë R. B.. Asnjëri nga ta nuk e ka kundërshtuar vendimin brenda 30 ditëve pas dorëzimit të tij.

Më 29 maj 2012, H. B., i lindur me 10 maj 1946, ka bërë ankesë kundër vendimit. Ai pretendon se babai i tij Z. B. i kishte blerë ngastrat e kontestuara në vitin 1946. Pastaj kjo tokë i ishte marrë më dhunë familjes nga autoriteti i atëhershëm duke i detyruar ata që të largohen nga Kosova dhe të shkojnë në Turqi. Kjo ka ndodhur në vitet e 60-ta të shekullit të njëzet. Pala ankuese në bazë të autorizimit që i është dhënë nga babai i tij është kthyer në Kosovë pas vitit 1999. Këtu ai zbuloi se toka ishte kultivuar para fillimit të luftës nga B. J.. Pastaj ai ka paraqitur kërkesë në gjykatën komunale vendore dhe në të njëjtën kohë ka ndërtuar një shtëpi të vogël në këtë tokë dhe e ka shkruar në të se ajo nuk është për shitje dhe se kjo është toka e tij (e H. B.). Ai ka vazhduar me kontestin në gjykatën e Gjilanit për të zgjidhur çështjen me R.J.. Ai pohon se nuk ishte në njohuri për ekzistencën e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe se kishte dëgjuar për të kur kishte mësuar se kishte qenë një person nga AKP-ja që kishte bërë fotografimin e tokës dhe pastaj pala ankuese kishte shkuar në Agjenci për të mësuar se çfarë po ndodhte. Aty, (në AKP) atij i është thënë se një person i quajtur R. H. B. është përfshirë, por ky R. nuk ka asgjë të bëjë me këtë tokë. Ai (pala ankuese) mendon se paraqitësi i kërkesës qëllimisht nuk e kishte njoftuar AKP-në se ky R. ishte personi i gabuar, ajo e di se familja e palës përgjegjëse në kërkesë është ajo që zotëron tokën.

Paraqitësja e kërkesës, tani pala përgjegjëse në ankesë, ka paraqitur përgjigje në ankesë. Ajo pohon se ankesa nuk duhet të shqyrtohet sipas meritave të saja pasi që pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën pran AKP-së. Në mënyrë alternative, ajo pretendon se provat e paraqitura nga pala ankuese nuk janë relevante.

Arsyetim ligjor:

Lidhur me pranueshmërinë e ankesës

Ankesa është papranueshme për shkak të arsyeve procedurale (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079) pasi që pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë.

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 thekson si në vijim: ”Brenda tridhjetë (30) ditëve prej njoftimit të palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit për kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë [..] “. Po ashtu neni 176.1 i Ligjit 03/L-006 për Procedurën Kontestimore parashih se e drejta e paraqitjes së ankesës iu takon palëve në procedurën në shkallë të parë.

Palë në kërkesë dhe në procedurat e përafërta është *“çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën e kërkuar[...], me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me nenin 10.1”* (sipas nenit 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, theksimi i shtuar).

Megjithatë, H. B., nuk ka qenë palë në procedurën në shkallë të parë pranë KKKP-së. Për të sqaruar një situatë të këtillë, pala ankuese pohon se ai nuk ishte në dijeni të këtyre procedurave. Në të vërtetë, neni 10.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 thekson: *“Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës.”*

Prandaj, Gjykata Supreme duhet të verifikojë nëse pala ankuese ishte njoftuar për kërkesën. Mënyra e njoftimit të kërkesës në këtë proces të veçantë masiv të procedimit të kërkesave parashihet me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Sekretaria Ekzekutive, duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person që mund të ketë interes ligjor në pronën objekt i kërkesës.

Gjykata konstaton se në përgjigje të njërit nga njoftimet (atë të vitit 2009), pala përgjegjëse në kërkesë R. H. B. ka njoftuar se ka interes ligjor në procedurë, por jo edhe pala ankuese H. B.. Ka qenë edhe një njoftim tjetër i datës 1 qershor 2006, kur një lajmërim ishte vendosur para objektit të cilin pala ankuese pohon ta ketë ndërtuar vetë (siç mund të shihet në fotografinë në dosje - faqe 76 në dosjen e lëndës së KKKP-së). Pala ankuese nuk është përgjigjur as në këtë njoftim. Ai nuk ka dhënë ndonjë sqarim të arsyeshëm se përse nuk e ka njoftuar KKKP-në se ka interes ligjor dhe se dëshironte të merrte pjesë në procedurë. Përkundrazi, ai vetë sqaron (në ankesë) se kur kishte kuptuar se një person nga AKP-ja po fotografonte tokën, ai kishte shkuar në Agjenci dhe ishte interesuar personalisht për procedurën por nuk ka kërkuar që të përfshihet në të si palë e interesuar. Mund vetëm të konkludohet se pala ankuese ishte njoftuar për procedurën, kishte mundësi që të shprehte gatishmërinë e tij që merrte pjesë në të por ai nuk e ka bërë këtë, prandaj, ai nuk ka ndonjë arsyetim për mos-njoftimin e KKKP-së për gatishmërinë e tij për tu përfshirë si palë.

Pasi që pala ankuese H. B. nuk e kishte plotësuar obligimin për ta njoftuar AKP-në lidhur me interesin e tij në kërkesë, nuk ka justifikim për palën ankuese se pse ai nuk kishte marrë pjesë në procedurën në shkallë të parë pranë AKP-së. Prandaj, pala ankuese nuk mund të pranohet si palë në procedurë në shkallë të dytë pranë Kolegjit të Apelit të AKP-së. Ankesa hedhet poshtë si e palejueshme (neni 13.3 (b) Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079; shih gjithashtu nenin 195.1 të Ligjit për Procedurën Administrative).

Pasi që ankesa është e palejueshme, Gjykatës Supreme nuk i lejohet që të vendos për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat materiale të palëve.

Shpenzimet:

Në përputhje me Shtojcën III, nenin 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, palët përjashtohen prej shpenzimeve të procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Ndërkaq një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Kolegjit të Apelit. Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UA nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Kolegjit të Apelit.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet në 10 660 € : 103 €.

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që humb rastin. Në përputhje me nenin 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë është 15 ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it